


REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BUJQËSISË, USHQIMIT DHE
MBROJTJES SË KONSUMATORIT
MINISTRI

Prot 5070

UDHËZIM

Nr. *12* Datë *29.9* 2010

PËR

METODAT E MARRJES SË MOSTRAVE DHE ANALIZIMIT PËR
KONTROLLIN ZYRTAR TË NIVELEVE TË MYKOTOKSINAVE NË
PRODUKTET USHQIMORE

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës, Ligjit Nr. 9863, dt 28.01.2008 "Për Ushqimin", nenit 76 të Ligjit Nr.9590, dt 27.07.2006 "Për ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe komuniteteve Europiane e Shteteve të tyre antare" dhe V.K.M Nr.463, dt 05.07.2006 "Për miratimin e planit kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit" i ndryshuar me propozim të Drejtorisë së Përgjithshme të Politikave të Sigurisë Ushqimore dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

UDHËZOJ:

1. Ky Udhëzim përcakton metodat e marrjes së mostrave si dhe kriteret për përgatitjen e mostrave dhe analizave që kryhen për kontrollin zyrtar të niveleve të mykotoksinave në produktet ushqimore.
2. Për qëllimin e këtij Udhëzimi zbatohen përkufizimet e mëposhtme:
 - a) "lot", nënkupton sasinë e identifikueshme të një produkti ushqimor të shpërndarë në të njëjtën kohë dhe të konfirmuar zyrtarisht se ka karakteristika të përbashkëta të tilla si: origjinën, llojin, tipin e paketimit, ambalazhuesin, dërguesin.
 - b) "nënlot", nënkupton një pjesë të përcaktuar të një loti të madh për të aplikuar metodën e marrjes së mostrës mbi këtë pjesë; secili nënlot duhet të jetë fizikisht i ndarë dhe i identifikueshëm;

Adresa: Blvd."Deshmoret e Kombit" Nr.2
E-mail: Kabineti@mete.gov.al
Internet: <http://eeë.mete.gov.al>

Tel: +355 4 227617
Tel: +355 4 232833
Fax: +355 4 234052

- c) “**mostër shtesë**” nënkupton një sasi të materialit, të marrë prej një vendi të veçuar brenda lotit ose nënlotit;
 - d) “**mostër e përbërë**”, nënkupton totalin e kombinuar të gjithë mostrave shtesë të marra prej lotit ose nënlotit:
 - e) “**mostër laboratorike**”, nënkupton mostrën e caktuar për t’u dërguar në laborator.
3. Marrja e mostrave për kontrollin zyrtar të niveleve të mykotoksinave në produkte ushqimore kryhet në përputhje me metodat e paraqitura në Shtojcën I, të këtij Udhëzimi.
 4. Përgatitja e mostrës dhe metodat e analizave që përdoren për kontrollin zyrtar të niveleve të mykotoksinave në produkte ushqimore paraqiten në Shtojcën II, të këtij Udhëzimi.
 5. Ngarkohet Drejtorja e Përgjithëshme e Politikave të Sigurisë Ushqimore dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit për zbatimin e këtij Udhëzimi.

Ky Udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

GENCRULI



Adresa: Blvd. "Dëshmoret e Kombit" Nr.2
E-mail: Kabineti@mete.gov.al
Internet: <http://ëëë.mete.gov.al>

Tel: +355 4 227617
Tel: +355 4 232833
Fax: +355 4 234052

SHTOJCA I

METODAT E MARRJES SË MOSTRAVE PËR KONTROLLIN ZYRTAR TË NIVELEVE TË MYKOTOKSINAVE NË PRODUKTET USHQIMORE

A.1. Masa të përgjithshme

A.1.1. Personeli

Marrja e mostrës kryhet nga inspektori i Sigurisë Ushqimore

A.1.2. Materiali për tu mostruar

Mostra merret për çdo lot që kontrollohet. Në përputhje me masat specifike të marrjes së mostrave për mykotoksina të ndryshme, lotet e mëdha ndahen në nënlotë për t'u mostruar më vete.

A.1.3. Masa paraprake

Gjatë marrjes dhe përgatitjes së mostrave, merren masa paraprake për të mënjanuar çdo ndryshim i cili do të ndikojë:

- përmbajtjen e mikotoksinës, që ndikojnë negativisht përcaktimin analitik ose i bëjnë mostrat e përbëra jo përfaqësuese;
- sigurinë e produkteve ushqimore të loteve të mostruar.

Gjithashtu, të merren të gjitha masat e nevojshme për të garantuar sigurinë e personave që marrin mostrat.

A.1.4. Mostrat shtesë

Përsa i përket mostrave shtesë, merren në vende të ndryshme, të shpërndara në të gjithë lotin ose nënlotin. Nisja e procedurës do të bëhet duke regjistruar të gjitha të dhënat e përcaktuara në pikën A.1.8. të Shtojcës I.

A.1.5. Përgatitja e mostrës së përbërë

Mostra e përbërë përgatitet nga kombinimi i mostrave shtesë.

A.1.6. Mostrat përsëritëse

Mostra përsëritëse përdoret kur ka mospajtim të operatorit të biznesit me të dhënat e analizës. Mostra përsëritëse merret nga mostra e përbërë e homogjenizuar.

A.1.7. Paketimi dhe transportimi i mostrave

Secila mostër do të vendoset në një enë të pastër, të palëvizshëme për të shmangur kontaminimin dhe dëmtimin gjatë transportimit. Gjithashtu merren masat për të shmangur çdo ndryshim në përbërjen e kampionit, që mund të vijë gjatë transportit ose ruajtjes.

A.1.8. Mbyllja dhe etiketimi i mostrave

Secila mostër e marrë për kontroll zyrtar mbyllet në vendin e marrjes së mostrave dhe identifikohet.

Secila mostër e marrë do të regjistrohet duke bërë që çdo lot të identifikohet qartë, duke shënuar datën dhe vendin e marrjes së mostrës si edhe informacionin shtesë, në mënyrë të tillë që të jetë ndihmë për analizuesin.

A.2. Llojet e ndryshme të loteve

Produktet ushqimore mund të tregtohen në grumbull, kontenier, apo paketa individuale, të tilla si thasë, qese, paketa të shitjes me pakicë. Metoda e marrjes së mostrave mund të aplikohet në të gjitha format e ndryshme të tregtimit të mallrave.

Pa paragjykuar dispozitat e veçanta të paraqitura në pjesët e tjera të kësaj Shtojce, formula e mëposhtme mund të përdoret si udhëzues për marrjen e mostrës në lote që tregtohen në pako individuale të tilla si, thasë, qese, paketa të shitjes me pakicë.

$$\text{Frekuenca e mostrimit (Fm)/n} = \frac{\text{Pesha e lotës} \times \text{Pesha e mostrës shtesë}}{\text{Pesha e mostrës së përbërë} \times \text{Pesha e paketimit individual}}$$

-Pesha në kg

- Frekuenca e mostrimit (Fm): çdo frekuencë n e thesit apo qeses nga e cila mostra shtesë duhet të merret (shifra pas presjes dhjetore duhet të rrumbullakohet me numrin më të afërt).

Metoda e marrjes së mostrave të drithrave dhe produkteve të drithërave

Kjo metodë e marrjes së mostrave është e aplikueshme për kontrollin zyrtar të niveleve maksimale të përcaktuara për aflatoxin B1, aflatoxin totale, ochratoxin A dhe Fusarium-toksina në drithërat dhe produktet e drithërave.

B.1. Pesha e mostrës shtesë

Pesha e mostrës shtesë do të jetë rreth 100 gram, me përjashtim të rasteve kur përcaktohet në pjesën B të Shtojcës I.

Në rastin e loteve të shitjes me pakicë, pesha e mostrës shtesë do të varet nga pesha e paketës së shitjes me pakicë

Në rastin e paketave të shitjes me pakicë me më shumë se 100 gram, mostrat e përbëra do të peshojnë më shumë se 10 kg. Nëse pesha e një pakete të vetme të shitjes me pakicë është shumë më tepër se 100 gram, atëherë 100 gram do të merren nga çdo pako të shitjes me pakicë si mostër shtesë. Kjo mund të bëhet ose kur mostra është marrë ose në laborator. Megjithatë, në rastet kur metoda e marrjes së mostrave të tilla do të sillte pasoja të papranueshme komerciale që rezultojnë nga dëmtimet e lotit (për shkak të formave të paketimit, mjeteve të transportit, etj), atëherë mund të aplikohet një metodë alternative e marrjes së mostrave. Për shembull, në rastin kur një produkt i vlefshëm tregtohet në pako me pakicë me 500 gram ose 1 kg, mostra e përgjithshme mund të merret nga grumbullimi i një numër mostrash shtesë që është më i vogël se numri i treguar në tabelën 1 të gjermës B2 dhe tabelën 2 të gjermës B4, me kusht që pesha e mostrës së përbërë të jetë e barabartë me peshën e kërkuar të mostrës së përbërë, përmendur në këto tabela.

Kur paketa e shitjes me pakicë është më pak se 100 gram dhe nëse ndryshimi nuk është shumë i madh, paketa e shitjes me pakicë do të konsiderohet si një mostër shtesë, që sjell si rezultat një mostër të përbërë më pak se 10 kg. Nëse pesha e paketës së shitjes me pakicë është shumë më pak se 100 gram, mostra shtesë do të përbëhet nga dy ose më shumë pako të shitjes me pakicë, me qëllim që 100 gram të përafrohen sa më shumë të jetë e mundur.

B.2. Shqyrtim i përgjithshëm i metodës së marrjes së mostrës për drithërat dhe produktet e drithërave.

Tabela 1

Nëndarja e loteve në nënlote në varësi të produktit dhe peshës së lotit

Produkti	Pesha e lotit(t)	Pesha ose nr i nënloteve	Nr i mostrave shtesë	Pesha e mostrës së përbërë(kg)
Drithërat dhe produktet drithërave	>1500	500 t	100	10
	>300<1500	3 nënlote	100	10
	>50<300	100 t	100	10
	<50	-	3-100(*)	1-10

(*) varet nga pesha e lotit - shih tabelën 2 gjërma B4

B.3. Metoda e marrjes së mostrave për drithërat dhe produktet e drithërave për lotet ≥ 50 ton

- Me kusht që nënloti mund të ndahet fizikisht, çdo lot ndahet në nënlote si në Tabelën 1 të gërmës B2. Duke marrë parasysh se pesha e lotit nuk është gjithmonë një shumë ekzakte e peshës së nënloteve, pesha e nënlotit mund të tejkalojë peshën e përmendur me një maksimum prej 20%. Në rast se loti nuk mund të ndahet fizikisht në nënlote, minimalisht merren 100 mostra shtesë prej lotit.

- Secili nënlot mostrohet veçmas.

- Numri i mostrave shtesë është 100. Pesha e mostrës së përbërë = 10 kg.

- Nëse nuk është e mundur të kryhet metoda e marrjes së mostrave të caktuara në këtë pikë për shkak të pasojave tregtare të papranueshme që vijnë nga dëmtimet e lotit (për shkak të formave të paketimit, mjeteve të transportit, etj), aplikohet një metodë alternative e marrjes së mostrave me kusht që kjo të jetë sa më përfaqësuese dhe të përshkruhet dhe dokumentohet plotësisht. Një metodë alternative e marrjes së mostrave mund të zbatohet në rastet kur është e pamundur të aplikohet metoda e mësipërme. Kjo zbatohet në rastet kur lotet e mëdhenj të drithërave ruhen në depo apo kur drithërat ruhen në sillose.

B.4. Metoda e marrjes së mostrave për drithërat dhe produktet e drithërave për lote <50 ton

Për lotet e drithërave dhe produkteve të drithërave më pak se 50 ton, plani i marrjes së mostrave është 10-100 mostra shtesë në varësi të peshës së lotit, dhe pesha e mostrës së përbërë varion 1-10 kg. Për lote shumë të vegjël ($\leq 0,5$ ton) merren një numër më i vogël mostrash shtesë, por mostra e përbërë e formuar nga mostrat shtesë do të jetë të paktën 1 kg.

Të dhënat në Tabelën 2 të kësaj gërme mund të përdoren për të përcaktuar numrin e mostrave shtesë që do të merren.

Tabela 2

Numri i mostrave shtesë që do të merren në varësi të peshës së lotit të drithërave dhe të produkteve të drithërave

Pesha e lotit në ton	Nr i mostrave shtesë	Pesha e mostrës së përbërë (kg)
<0.005	3	1
$> 0.005 - \leq 0.5$	5	1
$> 0.5 - \leq 1$	10	1
$> 1 - \leq 3$	20	2
$> 3 - \leq 10$	40	4
$> 10 - \leq 20$	60	6
$> 20 - \leq 50$	100	10

B.5. Marrja e mostrës në fazën e shitjes me pakicë

Marrja e mostrave të produkteve ushqimore në fazën e shitjes me pakicë duhet të bëhet kur të jetë e mundur në përputhje me dispozitat e përcaktuara në pjesën B të Shtojcës I.

Kur kjo nuk është e mundur, zbatohet një metodë alternative e marrjes së mostrave në fazën e shitjes me pakicë me kusht që ajo siguron se mostra e përbërë është mjaft përfaqësuese e lotit të mostruar dhe është plotësisht e përshkruar dhe e dokumentuar. Në çdo rast, pesha e mostrës së përbërë duhet të jetë të paktën 1 kg.

B.6. Pranimi i lotit ose nënlotit

- Pranohet nëse mostra laboratorike përputhet me kufirin maksimal, duke marrë parasysh korigjimin dhe pasiguritë në matje;
- Refuzohet nëse mostra laboratorike tejkalon limitin maksimal mbi atë të pranueshëm duke marrë parasysh korigjimin dhe pasiguritë në matje.

C. METODA E MARRJES SË MOSTRAVE PËR FRUTA TË THATA, DUKE PËRFSHIRË EDHE FRUTAT E THATA TË HARDHIVE DHE PRODHIMEVE TË PËRFTUARA, ME PËRJASHTIM TË FIQVE TË THATË

Kjo metodë e marrjes së mostrave aplikohet për kontrollin zyrtar të niveleve maksimale të përcaktuara për:

- aflatoxina B1 dhe aflatoxina totale në fruta të thata, me përjashtim të fiquve të thatë dhe;
- ochratoxin A në fruta të thata të hardhisë (rrush pa fara, stafidhe dhe sultanas).

C.1. Pesha e mostrës shtesë

Pesha e mostrës shtesë duhet të jetë rreth 100 gram, me përjashtim të rasteve kur përcaktohet në pjesën C të Shtojcës I.

Në rastin e loteve të paketimeve të shitjes me pakicë, pesha e mostrës shtesë varet nga pesha e paketimit të shitjes me pakicë.

Në rastin e paketave të shitjes me pakicë me më shumë se 100 gram, mostra e përbërë do të peshojë më shumë se 10 kg. Nëse pesha e një paketë të vetme të shitjes me pakicë është shumë më tepër se 100 gram, atëherë 100 gram do të merren nga secila paketë individuale të shitjes me pakicë, si një mostër shtesë. Kjo mund të bëhet ose kur mostra është marrë ose në laborator. Megjithatë, në rastet kur metoda e marrjes së mostrave të tilla do të çojë në pasoja të papranueshme tregtare si rezultat i dëmtimit të lotit (për shkak të formave të paketimit, mjeteve të transportit, etj), atëherë mund të aplikohet një metodë

alternative e marrjes së mostrave. Për shembull, në rastin kur një produkt i vlefshëm tregtohet në pako të shitjes me pakicë me peshë 500 gram ose 1 kg, mostra e përbërë mund të merret nga bashkimi i një numri mostrash shtesë që është më i vogël se numri i treguar në tabelën 1 të gjurmës C2 dhe tabelën 2 të gjurmës C4, me kusht që pesha e mostrës së përbërë të korrespondojë me peshën mostres së përbërë përmendur në këto tabela.

Kur paketa e shitjes me pakicë është më pak se 100 gram dhe nëse ndryshimi nuk është shumë i madh, paketa e shitjes me pakicë do të konsiderohet si një mostër shtesë, që sjell si rezultat një mostër të përbërë më pak se 10 kg. Nëse pesha e paketës së shitjes me pakicë është shumë më pak se 100 gram, mostra shtesë do të përbëhet nga dy ose më shumë pako të shitjes me pakicë, me qëllim që 100 gram të përafrohen sa më shumë të jetë e mundur.

C.2. Shqyrtim i përgjithshëm i metodës së mostrimit të frutave të thata, me përjashtim të fijeve

Tabela 1

Nënndarje e loteve në nënlote në varësi të produktit dhe peshës së lotit

Produkti	Pesha e lotit (ton)	Pesha ose numri i nënlotit	Numri i mostrave shtesë	Pesha totale e mostrës (kg)
Fruta të thata	≥ 15	15 – 30 ton	100	10
	< 15	-	10 – 100 (*)	1-10
(*) Në varësi nga pesha e lotit – shih Tabelën 2 të gjurmës C4				

C.3. Metoda e marrjes së mostrave për fruta të thata (lote ≥ 15 ton), me përjashtim të fijeve.

- Me kusht që nënloti mund të ndahet fizikisht, çdo lot ndahet në nënlote si në Tabelën 1 të gjurmës C2. Duke marrë parasysh se pesha e lotit nuk është gjithmonë një shumë e saktë e peshës së nënloteve, pesha e nënlotit mund të tejkalojë peshën e përmendur me një maksimum prej 20%.

- Çdo nënlot të mostrohet më vetë.

- Numri i mostrave shtesë të jetë 100. Pesha e mostrës së përbërë = 10 kg.

- Nëse nuk është e mundur të kryhet metoda e marrjes së mostrave si përshkruhet më sipër për shkak të pasojave tregtare, si rezultat i dëmtimeve të lotit (për shkak të formave të paketimit, mjeteve të transportit, etj) mund të aplikohet një metodë alternative e marrjes së mostrave me kusht që të jetë përfaqësuese, plotësisht e përshkruar dhe dokumentuar.

C.4. Metoda e marrjes së mostrave për fruta të thata (lote <15 ton), me përjashtim të fiqve

Për lotet e frutave të thata nën 15 ton, me përjashtim të fiqve, plani i marrjes së mostrave është 10-100 mostra shtesë, në varësi të peshës të lotit dhe pesha e mostrës së përbërë varjon 1 deri 10 kg.

Të dhënat në tabelën e mëposhtme të përdoren për të përcaktuar numrin e mostrave shtesë që do të merren.

Tabela 2

Numri i mostrave shtesë që do të merren në varësi të peshës së lotit të frutave të thata

Pesha e lotit (ton)	Numri i mostrave shtesë	Pesha e mostrës së përbërë (kg)
$\leq 0,1$	10	1
$> 0,1-\leq 0,2$	15	1,5
$> 0,2-\leq 0,5$	20	2
$> 0,5-\leq 1,0$	30	3
$> 1,0-\leq 2,0$	40	4
$> 2,0-\leq 5,0$	60	6
$> 5,0-\leq 10,0$	80	8
$> 10,0-\leq 15,0$	100	10

C.5. Marrja e mostrës në fazën e shitjes me pakicë

Marrja e mostrave të produkteve ushqimore në fazën e shitjes me pakicë bëhet në përputhje me dispozitat e përcaktuara në këtë pjesë të Shtojcës I.

Kur kjo nuk është e mundur, zbatohet një metodë alternative e marrjes së mostrave në fazën e shitjes me pakicë me kusht që ajo siguron se mostra e përbërë është mjaft përfaqësuese e lotit të mostruar dhe është plotësisht e përshkruar dhe e dokumentuar. Në çdo rast, pesha e mostrës së përbërë duhet të jetë të pakën 1 kg.

C.6. Dispozitat e veçanta për marrjen e mostrave të frutave të thata, me përjashtim të fiqve të thatë që tregtohen në pako me vakum

Për lote të barabarta me ose më shumë se 15 ton do të merren të paktën 25 mostra shtesë që çojnë në 10 kg mostër të përbërë dhe për lote më pak se 15 ton, do të merret 25% e numrit të mostrave shtesë të përmendura në Tabelën 2 të gjurmës C4 si rezultat pesha e mostrës së përbërë korrespondon me peshën e lotit të mostruar (shih Tabelën 2 të gjurmës C4).

C.7. Pranimi i një loti ose nënloti

- Pranohet nëse mostra laboratorike përputhet me kufirin maksimal, duke marrë parasysh korrigjimin dhe pasiguritë në matje;
- Refuzohet nëse mostra laboratorike tejkalon limitin maksimal mbi atë të gjykueshëm duke marrë parasysh korrigjimin dhe pasiguritë në matje.

D. METODA E MARRJES SË MOSTRAVE PËR FIQ TË THATË, KIKIRIKË DHE ARRA

Kjo metodë e marrjes së mostrave aplikohet për kontrollin zyrtar të niveleve maksimale të përcaktuara për aflatoxin B1 dhe gjithë aflatoxinave në fiq thatë, kikirikë dhe arra.

D.1. Pesha e mostrës shtesë

Pesha e mostrës shtesë do të jetë rreth 300 gram, me përjashtim të rasteve kur përcaktohet në pjesën D të Shtojcës I.

Në rastin e loteve të paketave të shitjes me pakicë, pesha e mostrës shtesë varet nga pesha e pakos së shitjes me pakicë.

Në rastin e paketave të shitjes me pakicë me më shumë se 300 gram, mostra e përbërë do të peshojë më shumë se 30 kg. Nëse pesha e një paketë të vetme të shitjes me pakicë është shumë më tepër se 300 gram, atëherë 100 gram do të merren nga secila paketë individuale të shitjes me pakicë, si një mostër shtesë. Kjo mund të bëhet ose kur mostra është marrë ose në laborator. Megjithatë, në rastet kur metoda e marrjes së mostrave të tilla do të çojë në pasoja të papranueshme tregtare si rezultat i dëmtimit të lotit (për shkak të formave të paketimit, mjeteve të transportit, etj), atëherë mund të aplikohet një metodë alternative e marrjes së mostrave. Për shembull, në rastin kur një produkt i vlefshëm tregtohet në pako të shitjes me pakicë me peshë 500 gram ose 1 kg, mostra e përbërë mund të merret nga bashkimi i një numri mostrash shtesë, me kusht që pesha e mostrës së përbërë të korrespondojë me peshën mostres së përbërë përmendur në tabelën 1 të germës D2, tabelën 2 të germës D4 dhe tabelën 3 të germës D5.

Kur paketa e shitjes me pakicë është më pak se 300 gram dhe nëse ndryshimi nuk është shumë i madh, paketa e shitjes me pakicë do të konsiderohet si një mostër shtesë, që sjell si rezultat një mostër të përbërë më pak se 30 kg. Nëse pesha e paketës së shitjes me pakicë është shumë më pak se 300 gram, mostra shtesë do të përbëhet nga dy ose më shumë pako të shitjes me pakicë, me qëllim që 300 gram të përafrohen sa më shumë të jetë e mundur.

D.2. Shqyrtim i përgjithshëm i metodës së marrjes së mostrave për fiq thatë, kikirikë dhe arra

Tabela 1
Nëndarje e loteve në nënlote në varësi të produktit dhe peshës së lotit

Produkti	Pesha e lotit (ton)	Pesha ose numri nënloteve	Numri i mostrave shtesë	Pesha e mostrës (kg) së përbërë
Fiq të thatë	≥ 15	15-30 ton	100	30
	< 15	-	10-100 (*)	≤ 30
Kikirikë, fistiqe, arra braziliane dhe arra të tjera	≥ 500	100 ton	100	30
	< 125 dhe < 500	5 nënlote	100	30
	≥ 15 dhe ≤ 125	25 ton	100	30
	< 15	-	10-100 (*)	≤ 30

(*) Në varësi nga pesha e lotit – shih Tabelën 2 të gjurmës D4 të kësaj Shtojce.

D.3. Metoda e marrjes së mostrave për fiq thatë, kikirikë dhe arra (lote ≥ 15 ton)

- Me kusht që nënloti mund të ndahet fizikisht, çdo lot ndahet në nënlote si në Tabelën 1 të gjurmës D2. Duke marrë parasysh se pesha e lotit nuk është gjithmonë një shumë e saktë e peshës së nënloteve, pesha e nënlotit mund të tejkalojë peshën e përmendur me një maksimum prej 20%.

- Çdo nënlot të mostrohet më vetë.

- Numri i mostrave shtesë të jetë 100.

Pesha e mostrës së përbërë = 30 kg do të përzihet dhe ndahet në tre mostra laboratorike të barabarta me 10 kg secila para bluarjes (kjo ndarje në tre mostra laboratorike nuk është e nevojshme në rastet e kikirikëve dhe arrave që i nënshtrohen ndarjes së mëtejshme ose trajtimit fizik që është i vlefshëm për homogjenizimin e mostrës prej 30 kg).

- Secila mostër laboratorike me 10 kg do të ndahet dhe të përziehet tërësisht për të arritur homogjenizim të plotë në përputhje me dispozitat e vendosura në Shtojcën II.

- Nëse nuk është e mundur të kryhet metoda e marrjes së mostrave e përshkruar më sipër për shkak të pasojave tregtare që vijnë si pasojë e dëmtimeve të lotit (për shkak të formave të paketimit, mjeteve të transportit, etj) mund të aplikohet një metodë alternative e marrjes së mostrave me kusht që të jetë sa më përfaqësuese dhe plotësisht e përshkruar dhe dokumentuar.

D.4. Metoda e marrjes së mostrave për fiq thatë, kikirikë dhe arra (lote < 15 ton)

Numri i mostrave shtesë të marra varet nga pesha e lotit dhe varjon me një minimum prej 10 dhe maksimum prej 100.

Të dhënat në tabelën 2 të kësaj gërme mund të përdoren për të përcaktuar numrin e mostrave shtesë të marra dhe ndarjen pasuese të mostrës së përbërë.

Tabela 2

Numri i mostrave shtesë të marra në varësi të peshës së lotit dhe numrit nëndarjes së mostrës së përbërë

Pesha e lotit në ton	Numri i mostrave shtesë	Pesha e mostrës së përbërë në kg (në rastin me pakice pesha e mostrës së përb. devijon shih pikën D.1)	Numri i mostrave laboratorike prej mostrës së përbërë
$\leq 0,1$	10	3	1
$> 0,1 - \leq 0,2$	15	4,5	1
$> 0,2 - \leq 0,5$	20	6	1
$> 0,5 - \leq 1,0$	30	9 (-< 12 kg)	1
$> 1,0 - \leq 2,0$	40	12	2
$> 2,0 - \leq 5,0$	60	18 (-< 24 kg)	2
$> 5,0 - \leq 10,0$	80	24	3
$> 10,0 - \leq 15,0$	100	30	3

Pesha e mostrës së përbërë ≤ 30 kg do të përzihet dhe ndahet në dy ose tre mostra laboratorike të barabarta me ≤ 10 kg secila para bluarjes (kjo ndarje në dy ose tre mostra laboratorike nuk është e nevojshme në rastet e fivqe të thatë, kikirikëve dhe arrave që i nënshtrohen ndarjes të mëtejshme ose trajtimit fizik që është i vlefshëm për homogjenizimin e mostrave prej 30 kg).

Në rastet kur pesha e mostrës së përbërë është më pak se 30 kg, mostra e përbërë do të ndahet në mostrave laboratorike sipas udhëzimeve në vijim:

- <12 kg: nuk ndahet në mostra laboratorike

- ≥ 12 - <24 kg: ndahet në dy mostra laboratorike

- ≥ 24 kg: ndahet në tri mostra laboratorike

- Çdo mostër laboratorike do të bluhet hollë veçmas dhe përzihet tërësisht për të arritur homogjenizim të plotë në përputhje me dispozitat e vendosura në Shtojcën II.

- Nëse nuk është e mundur të kryhet metoda e marrjes së mostrave e përshkruar më sipër për shkak të pasojave tregtare të papranueshme që vijnë si pasojë e dëmtimeve të lotit (për shkak të formave të paketimit, mjeteve e transportit, etj) mund të aplikohet një metodë alternative e marrjes së mostrave me kusht që të jetë sa më përfaqësuese dhe plotësisht e përshkruar dhe dokumentuar.

D.5. Metoda e marrjes së mostrave për produktet ushqimore të prejardhura dhe ushqimet e përbëra

D.5.1. Produktet e prejardhura me grimca me peshë shumë të vogla, si mielli, gjalpi i kikirikut (kanë shpërndarje homogjene të kontaminimit me aflatoxin)

- Numri i mostrave shtesë është: 100, për lotet nën 50 ton numrin e mostrave shtesë do të jetë 10-100, në varësi të peshës së lotit (shih Tabelën 3 të kësaj gërme)

Tabela 3
Numri i mostrave shtesë që do të merren në varësi të peshës së lotit

Pesha e lotit (ton)	Numri i mostrave shtesë	Pesha totale e mostrës (kg)
≤ 1	10	1
$> 1-\leq 3$	20	2
$> 3-\leq 10$	40	4
$> 10-\leq 20$	60	6
$> 20-\leq 50$	100	100

- Pesha e mostrës shtesë do të jetë rreth 100 gram. Në rastet e loteve në paketimin e shitjes me pakicë, pesha e mostrës shtesë varet nga pesha e paketimit të shitjes me pakicë.

- Pesha e mostrës së përbërë = 1-10 kg e përzier mjaftueshëm.

D.5.2. Produktet e tjera të prejardhura me madhësi të grimcave relativisht të mëdha (ka një shpërndarje heterogjene të kontaminimit me aflatoxin)

Metoda e marrjes së mostrave dhe pranimit është si për fiq thatë, kikirikë dhe arra (D.3 dhe D.4)

D.6. Marrja e mostrave në fazën e shitjes me pakicë

Marrja e mostrave të produkteve ushqimore në fazën e shitjes me pakicë do të bëhet kur është e mundur në përputhje me dispozitat e përcaktuara në këtë pjesë të Shtojcës I.

Kur kjo nuk është e mundur, zbatohen metoda të tjera alternative të marrjes së mostrave në fazën e shitjes me pakicë me kusht që ato sigurojnë se mostra e përbërë është mjaft përfaqësuese e lotit të mostruar dhe plotësisht e përkruar dhe e dokumentuar. Në çdo rast, pesha e mostrës së përbërë duhet të jetë të pakën 1 kg.

D.7. Metoda të veçanta të marrjes së mostrave për kikirikët, arrat, fiqtë e thatë dhe nënproduktet që tregtohen në pako me vakum.

D.7.1. Fistikë, kikirikë, arra Brazili dhe fiq të thatë

Për lote të barabarta me ose më shumë se 15 ton do të merren të paktën 50 mostra shtesë që çojnë në 30 kg mostër të përbërë dhe për lote më pak se 15 ton, do të merret 50% e numrit të mostrave shtesë të përmendura në Tabelën 2 si rezultat pesha e mostrës së përbërë korrespondon me peshën e lotit të mostruar (shih Tabelën 2 të gjurmës D4).

D.7.2. Arra të tjera si fistikët dhe arrat e Brazilit

Për lote të barabarta me ose më shumë se 15 ton do të merren të paktën 25 mostra shtesë që çojnë në 30 kg mostër të përbërë dhe për lote më pak se 15 ton, do të merret 25% e numrit të mostrave shtesë të përmendura në Tabelën 2 të gjurmës D4 si rezultat pesha e mostrës së përbërë korrespondon me peshën e lotit të mostruar (shih Tabelën 2 të gjurmës D4).

D.7.3. Nënproduktet e arrave, fiqve dhe kikirikëve me grimca me madhësi të vogla

Për lote të barabarta me ose më shumë se 50 ton do të merren të paktën 25 mostra shtesë që çojnë në 10 kg mostër të përbërë dhe për lote më pak se 50 ton, do të merret 25% e numrit të mostrave shtesë të përmendura në Tabelën 3 të gjurmës D5 si rezultat pesha e mostrës së përbërë korrespondon me peshën e lotit të mostruar (shih Tabelën 3 të gjurmës D5).

D.8. Pranimi i lotit ose nënlotit

Për fiq të thatë, kikirikë dhe arra që i nënshtrohen një ndarje apo trajtimi tjetër fizik

- Pranohet nëse mostra e përbërë ose mesatarja e mostrës laboratorike përputhet me kufirin maksimal, duke marrë parasysh korrigjimin dhe pasiguritë në matje;
- Refuzohet nëse mostra totale ose mesatarja e mostrës së laboratorit tejkalon limitin maksimal duke marrë parasysh korrigjimin dhe pasiguritë në matje.

Për fiq të thatë, kikirikë dhe arra destinuar për konsum të drejtpërdrejtë human:

- Pranohet nëse asnjë nga mostrat laboratorike nuk tejkalojnë kufirin maksimal, duke marrë parasysh korrigjimin dhe pasiguritë në matje;
- Refuzohet nëse një ose më shumë nga mostrat laboratorike tejkalojnë kufirin maksimal mbi atë të gjykueshëm duke marrë parasysh korrigjimin dhe pasiguritë në matje.

Në rastet kur mostra e përbërë është 12 kg ose më pak

- Pranohet nëse mostra laboratorike përputhet me kufirin maksimal, duke marrë parasysh korrigjimin dhe pasiguritë në matje;
- Refuzohet nëse mostrat laboratorike tejkalojnë kufirin maksimal mbi atë të gjykueshëm duke marrë parasysh korrigjimin dhe pasiguritë në matje.

E. METODA E MARRJES SË MOSTRAVE PËR ERËZA

Kjo metodë e marrjes së mostrave aplikohet për kontrollin zyrtar të niveleve maksimale të përcaktuara për aflatoxin B1 dhe gjithë aflatoxinat në erëza.

E.1. Pesha e mostrës shtesë

Pesha e mostrës shtesë do të jetë rreth 100 gram, me përjashtim të rasteve kur përcaktohet në pjesën E të Shtojcës I.

Në rastin e loteve të paketave të shitjes me pakicë, pesha e mostrës shtesë varet nga pesha e pakos së shitjes me pakicë.

Në rastin e paketave të shitjes me pakicë me > 100 gram, mostra e përbërë do të peshojë më shumë se 10 kg. Nëse pesha e një paketë të vetme të shitjes me pakicë është >> 100 gram, atëherë 100 gram do të merren nga secila paketë individuale të shitjes me pakicë, si një mostër shtesë. Kjo mund të bëhet ose kur mostra është marrë ose në laborator. Megjithatë, në rastet kur metoda e marrjes së mostrave të tilla do të çojë në pasoja të papranueshme tregtare si rezultat i dëmtimit të lotit (për shkak të formave të paketimit, mjeteve të transportit, etj), atëherë mund të aplikohet një metodë alternative e marrjes së mostrave. Për shembull, në rastin kur një produkt i vlefshëm tregtohet në pako të shitjes me pakicë me peshë 500 gram ose 1 kg, mostra e përbërë mund të merret nga bashkimi i një numri mostrash shtesë që është më i vogël se numri i treguar në tabelën 1 të gjermës E2 dhe tabelën 2 të gjermës E4, me kusht që pesha e mostrës së përbërë të korrespondojë me peshën mostrës së përbërë përmendur në këto tabela.

Kur paketa e shitjes me pakicë është më pak se 100 gram dhe nëse ndryshimi nuk është shumë i madh, paketa e shitjes me pakicë do të konsiderohet si një mostër shtesë, që sjell si rezultat një mostër të përbërë më pak se 10 kg. Nëse pesha e paketës së shitjes me pakicë është shumë më pak se 100 gram, mostra shtesë do të përbëhet nga dy ose më shumë pako të shitjes me pakicë, me qëllim që 100 gram të përafrohen sa më shumë të jetë e mundur.

E.2. Shqyrtim i përgjithshëm i mënyrës së marrjes së mostrave për erëzat

Tabela 1

Nëndarja e loteve në nënlote në varësi të produktit dhe peshës së lotit

Produkti	Pesha e lotit (ton)	Pesha ose numri i nënlotit	Numri i mostrave shtesë	Pesha e mostrës së përbërë(kg)
Llojet	≥ 15	25 ton	100	10
	< 15	-	5-100 (*)	0,5-10

(*) Në varësi nga pesha e lotit – shih Tabelën 2 të gjermës E4 të kësaj Shtojce.

E.3. Metoda e marrjes së mostrave për erëza (lote ≥ 15 ton)

- Me kusht që nënloti mund të ndahet fizikisht, çdo lot ndahet në nënlote si në Tabelën 1 të gërmës E2. Duke marrë parasysh se pesha e lotit nuk është gjithmonë një shumë e saktë e peshës së nënloteve, pesha e nënlotit mund të tejkalojë peshën e përmendur me një maksimum prej 20%.

- Çdo nënlot të mostrohet më vete.

- Numri i mostrave shtesë të jetë 100. Pesha e mostrës së përbërë = 10 kg.

- Nëse nuk është e mundur të kryhet metoda e marrjes së mostrave si përshkruhet më sipër për shkak të pasojave tregtare, si rezultat i dëmtimeve të lotit (për shkak të formave të paketimit, mjeteve të transportit, etj) mund të aplikohet një metodë alternative e marrjes së mostrave me kusht që të jetë përfaqësuese, plotësisht e përshkruar dhe dokumentuar.

E.4. Metoda e marrjes së mostrave për erëzat (lote <15 ton)

Për lote të erëzave më pak se 15 ton plani i marrjes së mostrave është 5-100 mostra shtesë, në varësi të peshës të lotit dhe pesha e mostrës së përbërë varjon 0,5 deri 10 kg.

Të dhënat në tabelën e mëposhtme mund të përdoren për të përcaktuar numrin e mostrave shtesë të marra.

Tabela 2
Numri i mostrave shtesë të marra në varësi të peshës së lotit të erëzave

Pesha e lotit në ton	Numri i mostrave shtesë	Pesha e mostrës përbërë (kg)
≤ 0,01	5	0,5
>0,01-≤ 0,1	10	1
> 0,1-≤ 0,2	15	1,5
> 0,2-≤ 0,5	20	2
> 0,5-≤ 1,0	30	3
> 1,0-≤ 2,0	40	4
> 2,0-≤ 5,0	60	6
> 5,0-≤ 10,0	80	8
> 10,0-≤ 15,0	100	10

E.5. Marrja e mostrës në fazën e shitjes me pakicë

Marrja e mostrave të produkteve ushqimore në fazën e shitjes me pakicë do të bëhet kur është e mundur në përputhje me dispozitat e përcaktuara në këtë pjesë të Shtojcës I.

Kur kjo nuk është e mundur, zbatohet një metodë alternative e marrjes së mostrave në fazën e shitjes me pakicë me kusht që ajo siguron se mostra e përbërë është mjaft përfaqësuese e lotit të mostruar dhe është plotësisht e përshkruar dhe e dokumentuar. Në çdo rast, pesha e mostrës së përbërë duhet të jetë të paktën 0,5 kg.

E.6. Metoda të veçanta të marrjes së mostrave për erëza që tregtohen në pako me vakum

Për lote të barabarta me ose më shumë se 15 ton do të merren të paktën 25 mostra shtesë që çojnë në 10 kg mostër të përbërë dhe për lote më pak se 15 ton, do të merret 25% e numrit të mostrave shtesë të përmendura në Tabelën 2 të gërmës E4 si rezultat pesha e mostrës së përbërë korrespondon me peshën e lotit të mostruar (shih Tabelën 2 të gërmës E4).

E.7. Pranimi i lotit ose nenlotit

- Pranohet nëse mostra laboratorike përputhet me kufirin maksimal, duke marrë parasysh korrigjimin dhe pasiguritë në matje;
- Refuzohet nëse mostrat laboratorike tejkalojnë kufirin maksimal mbi atë të gjykueshëm duke marrë parasysh korrigjimin dhe pasiguritë në matje.

F. METODA E MARRJES SË MOSTRAVE PËR QUMËSHT DHE PRODUKTET E QUMËSHTIT; FORMULA PËR FOSH NJA DHE FORMULA PLOTËSUESE, QË PËRFSHIJNË QUMËSHT PËR FËMIJË DHE QUMËSHT PLOTËSUES.

Kjo metodë e marrjes së mostrave aplikohet për kontrollin zyrtar të niveleve maksimale përcaktuar për aflatoksinën M1 në qumësht dhe produktet e qumështit dhe formulat për foshnja dhe formulat plotësuese, që përfshijnë qumështin për foshnja, qumështin plotësues dhe ushqimet dietike (qumështi dhe produktet e qumështit) për qëllime të veçanta mjekësore destinuar në mënyrë specifike për foshnjat.

F.1. Metoda e marrjes së mostrave të qumështit, produktet e qumështit, formulat për foshnja dhe formulat plotësuese, që përfshijnë qumështin për foshnja dhe qumështin plotësues.

Mostra e përbërë do të jetë të paktën 1 kg ose 1 litër përveç kur nuk është e mundur p.sh. kur mostra përbëhet nga një shishe.

Numri minimal i mostrave shtesë të marra nga loti jepet në tabelën 1 të kësaj gërme. Numri i mostrave shtesë të përcaktuara është në funksion të mënyrës me të cilën tregtohet produkti. Në rastin e ngarkesave të produkteve të lëngshme loti do të përziehet tërësisht aq sa është e mundur dhe për aq sa kjo nuk ndikon në cilësinë e produktit, me dorë ose në mënyrë mekanike para marrjes së mostrave. Në këtë rast, përftohet një shpërndarje

homogjene e aflatoxinës M1 brenda lotit. Prandaj është e mjaftueshme të merren tre mostra shtesë nga një lot për të formuar mostrën e përbërë.

Mostrat shtesë, të cilat shpesh mund të jenë një shishe ose një paketë, do të kenë peshë të ngjashme. Pesha e një mostre shtesë do të jetë të paktën 100 gram, për pasojë mostra e përbërë do të jetë rreth 1 kg ose 1 l. Nisja e procedurës do të bëhet duke regjistruar të gjitha të dhënat e përcaktuara në pikën A.1.8. të Shtojcës I.

Tabela 1
Numri minimal i mostrave shtesë të marra nga loti

Forma e trgtimit	Volumi ose pasha e lotit (l ose kg)	Numri minimal i mostrave shtesë të dhëna	Volumi ose pasha minimale e mostrës së përbërë (l ose kg)
Bot	-	3-5	1
Shishe/kuti	≤ 50	3	1
Shishe/kuti	50 deri 500	5	1
Shishe/kuti	> 500	10	1

F.2. Marrja e mostrës në fazën e shitjes me pakicë

Marrja e mostrave të produkteve ushqimore në fazën e shitjes me pakicë bëhet në përputhje me dispozitat e përcaktuara në këtë pjesë të Shtojcës I.

Kur kjo nuk është e mundur, zbatohet një metodë alternative e marrjes së mostrave në fazën e shitjes me pakicë me kusht që ajo siguron se mostra e përbërë është mjaft përfaqësuese e lotit të mostruar dhe është plotësisht e përshkruar dhe dokumentuar.

F.3. Pranimi i lotit ose nënlotit

- Pranohet nëse mostra laboratorike përputhet me kufirin maksimal, duke marrë parasysh korrigjimin dhe pasiguritë në matje (ose kufizim vendimi - shih Shtojcën II, pika 4.4.);

- Refuzohet nëse mostrat laboratorike tejkalojnë kufirin maksimal mbi atë të gjykueshëm duke marrë parasysh korrigjimin dhe pasiguritë në matje (ose kufizim vendimi - shih Shtojcën II, pika 4.4.).

G. METODA E MARRJES SË MOSTRAVE NË KAFE DHE PRODUKTET E KAFES

Kjo metodë e marrjes së mostrave aplikohet për kontrollin zyrtar të niveleve maksimale e vendosur për ochratoxin A në kokrrat e kafes së pjekur, kafes së bluar dhe kafes së tretshme.

G.1. Pesha e mostrës shtesë

Pesha e mostrës shtesë do të jetë rreth 100 gram, me përjashtim të rasteve kur përcaktohet në pjesën G të Shtojcës I.

Në rastin e loteve të paketave të shitjes me pakicë, pesha e mostrës shtesë varet nga pesha e pakos së shitjes me pakicë.

Në rastin e paketave të shitjes me pakicë me më shumë se 100 gram, mostra e përbërë do të peshojë më shumë se 10 kg. Nëse pesha e një pakete të vetme të shitjes me pakicë është shumë më tepër se 100 gram, atëherë 100 gram do të merren nga secila paketë individuale të shitjes me pakicë, si një mostër shtesë. Kjo mund të bëhet ose kur mostra është marrë ose në laborator. Megjithatë, në rastet kur metoda e marrjes së mostrave të tilla do të çojë në pasoja të papranueshme tregtare si rezultat i dëmtimit të lotit (për shkak të formave të paketimit, mjeteve të transportit, etj), atëherë mund të aplikohet një metodë alternative e marrjes së mostrave. Për shembull, në rastin kur një produkt i vlefshëm tregtohet në pako të shitjes me pakicë me peshë 500 gram ose 1 kg, mostra e përbërë mund të merret nga bashkimi i një numri mostrash shtesë që është më i vogël se numri i treguar në tabelën 1 të gjermës G2 dhe tabelën 2 të gjermës G4, me kusht që pesha e mostrës së përbërë të korrespondojë me peshën e mostrës së përbërë përmendur në këto tabela.

Kur paketa e shitjes me pakicë është më pak se 100 gram dhe nëse ndryshimi nuk është shumë i madh, paketa e shitjes me pakicë do të konsiderohet si një mostër shtesë, që sjell si rezultat një mostër të përbërë më pak se 10 kg. Nëse pesha e paketës së shitjes me pakicë është shumë më pak se 100 gram, mostra shtesë do të përbëhet nga dy ose më shumë pako të shitjes me pakicë, me qëllim që 100 gram të përafrohen sa më shumë të jetë e mundur.

G.2. Shqyrtim i përgjithshëm i mënyrës së marrjes së mostrave për kafën e pjekur

Tabela 1

Nënndarja e lotit në nënlote në varësi të produktit dhe peshës së lotit

Produkti	Pesha e lotit në (ton)	Pesha ose nr i nënloteve	Nr i mostrave shtesë	Pesha e mostrës përbërë (kg)
Kafe e pjekur kokërr, e bluar dhe e tretur	≥ 15	15-30 ton	100	10
	< 15	-	10-100(*)	1-10

(*) Në varësi nga pesha e lotit – shih Tabelën 2 të gjermës G4 të kësaj Shtojce

G.3. Metoda e marrjes së mostrave për kafë të pjekur kokërr, kafë të pjekur të bluar, kafë të tretshme në (lote ≥ 15 ton)

- Me kusht që nënloti mund të ndahet fizikisht, çdo lot ndahet në nënlote si në Tabelën 1 të gjermës G2. Duke marrë parasysh se pesha e lotit nuk është gjithmonë një shumë

ekzakte e peshës së nënloteve, pesha e nënlotit mund të tejkalojë peshën e përmendur me një maksimum prej 20%.

- Çdo nënlot të mostrohet më vete.

- Numri i mostrave shtesë të jetë 100.

- Pesha e mostrës së përbërë = 10 kg.

- Nëse nuk është e mundur të kryhet metoda e marrjes së mostrave si përshkruhet më sipër për shkak të pasojave tregtare, si rezultat i dëmtimeve të lotit (për shkak të formave të paketimit, mjeteve të transportit, etj) mund të aplikohet një metodë alternative e marrjes së mostrave me kusht që të jetë sa më përfaqësuese, plotësisht e përshkruar dhe dokumentuar.

G.4. Metoda e marrjes së mostrave për kafe të pjekur kokërr, kafe të pjekur të bluar, kafe të tretshme në (lote < 15 ton)

Për kafe të pjekur kokërr, kafe të pjekur të bluar, kafe të tretshme nën 15 ton plani i marrjes së mostrave është 10 deri 100 mostra shtesë, në varësi të peshës të lotit, dhe pesha e mostrës së përbërë varjon 1 deri 10 kg.

Të dhënat në tabelën e mëposhtme mund të përdoren për të përcaktuar numrin e mostrave shtesë të marra.

Tabela 2

Numri i mostrave shtesë të marra në varësi të peshës së lotit për kafe të pjekur kokërr, kafe të pjekur të bluar, kafe të tretshme

Pesha e lotit (ton)	Numri i mostrave shtesë	Pesha e mostrës së përbërë (kg)
$\leq 0,1$	10	1
$> 0,1-\leq 0,2$	15	1,5
$> 0,2-\leq 0,5$	20	2
$> 0,5-\leq 1,0$	30	3
$> 1,0-\leq 2,0$	40	4
$> 2,0-\leq 5,0$	60	6
$> 5,0-\leq 10,0$	80	8
$> 10,0-\leq 15,0$	100	10

G.5. Metoda e marrjes së mostrave për kafe të pjekur kokërr, kafe të pjekur të bluar, kafe të tretshme tregtuar në pako me vakuum.

Për lote të barabarta me ose më shumë se 15 ton do të merren të paktën 25 mostra shtesë

që çojnë në 10 kg mostër të përbërë dhe për lote më pak se 15 ton, do të merret 25% e numrit të mostrave shtesë të përmendura në Tabelën 2 të gjermës G4, si rezultat pesha e mostrës së përbërë korrespondon me peshën e lotit të mostruar (shih Tabelën 2 të gjermës G4).

G.6. Marrja e mostrës në fazën e shitjes me pakicë

Marrja e mostrave të produkteve ushqimore në fazën e shitjes me pakicë bëhet në përputhje me dispozitat e përcaktuara në këtë pjesë të Shtojcës I.

Kur kjo nuk është e mundur, zbatohet një metodë alternative e marrjes së mostrave në fazën e shitjes me pakicë me kusht që ajo siguron se mostra e përbërë është mjaft përfaqësuese e lotit të mostruar dhe është plotësisht e përshkruar dhe e dokumentuar. Në çdo rast, pesha e mostrës së përbërë duhet të jetë të paktën 1 kg.

G.7. Pranimi i lotit ose nënlotit

- Pranohet nëse mostra laboratorike përputhet me kufirin maksimal, duke marrë parasysh korrigjimin dhe pasiguritë në matje;
- Refuzohet nëse mostrat laboratorike tejkalojnë kufirin maksimal mbi atë të gjykueshëm duke marrë parasysh korrigjimin dhe pasiguritë në matje.

H. METODA E MARRJES SË MOSTRAVE PËR LËNGJE FRUTASH QË PËRFSHIJNË: LËNG RRUSHI, MUSHT RRUSHI, VERË MOLLE DHE VERË

Kjo metodë e marrjes së mostrave aplikohet për kontrollin zyrtar të niveleve maksimale të përcaktuara për

- ochratoxin A në verë, lëng rrushi dhe mushti i rrushit dhe
- Patulin në lëngje frutash, nektar frutash, pije, musht dhe pijeve të tjera të fermentuara të përfutuara nga mollët ose që përmbajnë lëng molle.

H.1. Metoda e marrjes së mostrave

Mostra e përbërë do të jetë të paktën 1 litër përveç kur nuk është e mundur p.sh. kur mostra përbëhet nga një shishe.

Numri minimal i mostrave shtesë të marra nga loti jepet në tabelën 1 të kësaj gjërme. Numri i mostrave shtesë të përcaktuara është në funksion të mënyrës me të cilën tregtohet produkti. Në rastin e ngarkesave të produkteve të lëngshme loti do të përziehet tërësisht aq sa është e mundur dhe për aq sa kjo nuk ndikon në cilësinë e produktit, me dorë ose në mënyrë mekanike para marrjes së mostrave. Në këtë rast, përftohet një shpërndarje

homogjene e ochratoxin A dhe patulin brenda lotit. Prandaj është e mjaftueshme të merren tre mostra shtesë nga një lot për të formuar mostrën e përbërë.

Mostrat shtesë, të cilat shpesh mund të jenë një shishe ose një paketë, do të kenë peshë të ngjashme. Pesha e një mostre shtesë do të jetë të paktën 100 gram, për pasojë mostra e përbërë do të jetë rreth 1 litër. Nisja e procedurës do të bëhet duke regjistruar të gjitha të dhënat e përcaktuara në pikën A.1.8. të Shtojcës I.

Tabela 1
Numri minimal i mostrave shtesë të marra nga loti

Mënyra e tregtimit	Volumi i lotit (në litra)	Numri minimal i mostrave shtesë të mara	Volumi minimal i mostrës së përbërë (në l)
Ngarkesa (leng frutash, musht, verë)	-	3	1
Shishe/kuti (leng frutash, musht)	≤ 50	3	1
Shishe/kuti (leng frutash, musht)	50 deri 500	5	1
Shishe/kuti (leng frutash, musht)	> 50	10	1
Shishe/kuti vere	≤ 50	1	1
Shishe/kuti vere	50 deri 500	2	1
Shishe/kuti vere	> 500	3	1

H.2. Marrja e mostrës në fazën e shitjes me pakicë

Marrja e mostrave të produkteve ushqimore në fazën e shitjes me pakicë bëhet në përputhje me dispozitat e përcaktuara në këtë pjesë të Shtojcës I.

Kur kjo nuk është e mundur, zbatohet një metodë alternative e marrjes së mostrave në fazën e shitjes me pakicë me kusht që ajo siguron se mostra e përbërë është mjaft përfaqësuese e lotit të mostruar dhe është plotësisht e përshkruar dhe e dokumentuar.

H.3. Pranimi i lotit ose nënlotit

- Pranohet nëse mostra laboratorike përputhet me kufirin maksimal, duke marrë parasysh korrigjimin dhe pasiguritë në matje;

- Refuzohet nëse mostrat laboratorike tejkalojnë kufirin maksimal mbi atë të gjykueshëm duke marrë parasysh korrigjimin dhe pasiguritë në matje.

I. METODA E MARRJES SË MOSTRAVE PËR PRODUKTE SOLIDE TË MOLLËS, LËNG MOLLE DHE PRODUKTE SOLIDE TË MOLLËS PËR FOSH NJA DHE FËMIJË TË VEGJËL

Kjo metodë e marrjes së mostrave aplikohet për kontrollin zyrtar të niveleve maksimale të përcaktuara për patulin në produkte solide të mollës, lëngun e mollës dhe produktet solide të mollës për foshnja dhe fëmijë të vegjël.

I.1. Metoda e marrjes së mostrave

Mostra e përbërë do të jetë të paktën 1 kg përveç kur nuk është e mundur p.sh. kur mostra përbëhet nga një shishe.

Numri minimal i mostrave shtesë të marra nga loti jepet në tabelën 1 të kësaj germe. Në rastin e ngarkesave të produkteve të lëngshme loti do të përzihet tërësisht aq sa është e mundur dhe për aq sa kjo nuk ndikon në cilësinë e produktit, me dorë ose në mënyrë mekanike para marrjes së mostrave. Në këtë rast, përftohet një shpërndarje homogjene e patulin brenda lotit. Prandaj është e mjaftueshme të merren tre mostra shtesë nga një lot për të formuar mostrën e përbërë.

Mostrat shtesë do të kenë peshë të ngjashme. Peshja e një mostre shtesë do të jetë të paktën 100 gram, për pasojë mostra e përbërë do të jetë të paktën 1 kg. Nisja e procedurës do të bëhet duke regjistruar të gjitha të dhënat e përcaktuara në pikën A.1.8. të Shtojcës I.

Tabela 1
Numri minimal i mostrave shtesë të marra nga loti

Pesha e lotit (kg)	Numri minimal i mostrave të marra	Pesha e mostrave të përbëra (kg)
< 50	3	1
50 deri 500	5	1
> 500	10	1

Nëse loti përbëhet nga paketa individuale, atëherë numri i paketave të marra për të formuar mostrën e përbërë jepet në Tabelën 2 të kësaj germe

Tabela 2
Numri i paketave (mostrave shtesë) që do të merren për të formuar mostrën e përbërë nëse loti përbëhet nga paketa individuale

Numri i paketave ose njësive në lot	Numri i paketave ose njësive të marra	Pesha e mostrës së përbërë (kg)
1 deri 25	1 pako ose njësi	1
26 deri 100	Rreth 5% në të paktën 2 pako ose njësi	1

>	Rreth 5% në maksimumi 10 pako ose njësi	1
---	---	---

I.2. Marrja e mostrës në fazën e shitjes me pakicë

Marrja e mostrave të produkteve ushqimore në fazën e shitjes me pakicë bëhet në përputhje me dispozitat e përcaktuara në këtë pjesë të Shtojcës I.

Kur kjo nuk është e mundur, zbatohet një metodë alternative e marrjes së mostrave në fazën e shitjes me pakicë me kusht që ajo siguron se mostra e përbërë është mjaft përfaqësuese e lotit të mostruar dhe është plotësisht e përshkruar dhe e dokumentuar.

I.3. Pranimi i lotit ose nënlotit

- Pranohet nëse mostra laboratorike përputhet me kufirin maksimal, duke marrë parasysh korrigjimin dhe pasiguritë në matje;

- Refuzohet nëse mostrat laboratorike tejkalojnë kufirin maksimal mbi atë të gjykueshëm duke marrë parasysh korrigjimin dhe pasiguritë në matje.

J. METODA E MARRJES SË MOSTRAVE PËR USHQIMET PËR BEBE DHE USHQIMET E PËRPUNUARA ME BAZË DRITHËRASH PËR FOSH NJA DHE FËMIJË TË VEGJËL

Kjo metodë e marrjes së mostrave aplikohet për kontrollin zyrtar të niveleve maksimale të përcaktuara:

- Për aflatoxina, ochratoxin A dhe Fusarium-toksin në ushqimin për bebe dhe ushqimet me bazë drithërash të përpunuara për foshnjat dhe fëmijë të vegjël,

- Për aflatoxina dhe ochratoxin A në ushqimet dietike për qëllime të veçanta mjekësore (të tjera përveç qumështit dhe produkteve të qumështit) destinuar në mënyrë specifike për foshnjat dhe

- Për patulin në ushqimin për bebe të tjera nga ushqimet me bazë drithërash të përpunuara për foshnja dhe fëmijë të vegjël. Për kontrollin e e niveleve maksimale të përcaktuara për patulin në lëng molle dhe produkteve solide të mollës për foshnjat dhe fëmijët e vegjël do të aplikohet mënyra e marrjes së mostrave që përshkruhet në pjesën 1 të Shtojcës I.

J.1. Metoda e marrjes së mostrave

- Metoda e marrjes së mostrave për drithërat dhe produktet e drithërave siç paraqitet në pikën B.4 të Shtojcës I do të aplikohet për ushqime të destinuar për foshnje dhe fëmijë të vegjël. Prandaj numri i mostrave shtesë të marra do të varet nga pesha e lotit, me një

minimum 10 dhe një maksimum 100, sipas Tabelës 2 të gjurmës B.4 e shtojcës I. Për lote shumë të vogla ($\leq 0,5$ ton) mund të merret një numër më i ulët i mostrave shtesë, por mostra e përbërë nga bashkimi i gjithë mostrave shtesë do të jetë edhe në këtë rast të paktën 1 kg.

- Pesha e mostrës shtesë do të jetë rreth 100 gram. Në rastin e loteve në paketimin e shitjes me pakicë, pesha e mostrës shtesë do të varet nga pesha e paketimit të shitjes me pakicë dhe në rastin e loteve shumë të vogla ($\leq 0,5$ ton) mostrat shtesë do të kenë një peshë të tillë që nga bashkimi i mostrave shtesë rrjedh një mostër e përbërë me të paktën 1 kg. Nisja e procedurës do të bëhet duke regjistruar të gjitha të dhënat e përcaktuara në pikën A.1.8. të Shtojcës I.

- Pesha e mostrës së përbërë = 10-10 kg mjaft të përziera.

J.2. Marrja e mostrës në fazën e shitjes me pakicë

Marrja e mostrave të produkteve ushqimore në fazën e shitjes me pakicë bëhet në përputhje me dispozitat e përcaktuara në këtë pjesë të Shtojcës I.

Kur kjo nuk është e mundur, zbatohet një metodë alternative e marrjes së mostrave në fazën e shitjes me pakicë me kusht që ajo siguron se mostra e përbërë është mjaft përfaqësuese e lotit të mostruar dhe është plotësisht e përshkruar dhe e dokumentuar.

J.3. Pranimi i lotit ose nënlotit

- Pranohet nëse mostra laboratorike përputhet me kufirin maksimal, duke marrë parasysh korrigjimin dhe pasigurinë në matje;

- Refuzohet nëse mostrat laboratorike tejkalojnë kufirin maksimal mbi atë të gjykueshëm duke marrë parasysh korrigjimin dhe pasigurinë në matje.

SHTOJCA II

KRITERET PËR PËRGATITJEN E MOSTRËS DHE PËR METODAT E ANALIZAVE TË PËRDORURA PËR KONTROLLIN ZYRTAR TË NIVELIT TË MYKOTOKSINAVE NË PRODUKTET USHQIMORE

HYRJE

1,1. Masa paraprake

-Meqënëse shpërndarja e mykotoksinave në përgjithësi është jo-homogjene, mostrat do të përgatiten dhe sidomos homogjenizohen, me shumë kujdes.

-Përgatitja dhe homogjenizimi i mostrës bëhet në laborator.

-Gjatë procedurës së analizave të aflatoxinës, drita e diellit duhet të eliminohet sa më shumë të jetë e mundur, sepse aflatoxina bie gradualisht nën ndikimin e rrezeve ultravjollcë.

1,2. Llogaritja e raportit të lëvozhgë/thelb te arrat e plota

Kufijtë e caktuar për aflatoxinat në Urdhërin nr. 182, date 25.05.2007 “Mbi vendosjetn e niveleve maksimale për kontaminuesit ushqimor”, zbatohen për pjesën e ngrënshme. Niveli i aflatoksinave për pjesën e ngrënshme të tyre përcaktohet për:

-Mostrat e arrave “me lëvozhgë”, duhet të pastrohen nga lëvozhga dhe niveli i aflatoxinave të përcaktohet për pjesën e ngrënshme.

-Arrat “me lëvozhgë” duhet të merren nëpërmjet procedurës së përgatitjes së mostrës. Metoda e mostrimit dhe analizave do të vlerësojnë peshën e thelbinjve të arrës në mostrën e përbërë. Pësia e thelbinjve në mostrën e përbërë do të llogaritet pas vendosjes së një elementi të përshtatshëm për raportin midis lëvozhgës dhe thelbinjve për mostrën në tërësi. Ky raport përdoret për përcaktimin e vlerës së thelbit në mostrën e ngarkesës që merret përmes përgatitjes së mostrës dhe metodës së analizave.

Afërsisht merren 100 kokrra të plota, në mënyrë të rastësishme nga i gjithë loti që lihen veç nga secila mostër e përbërë. Raporti mund të arrihet për secilën mostër laboratorike nga peshimi i kokrrave të plota, lëvozhgës dhe ripeshimi i lëvozhgës dhe pjesëve të thalbeve.

Megjithatë, raporti midis lëvozhgave dhe thelbinjve mund të përcaktohet në laborator si rezultat i analizimit të një sërë mostrash, që mund të merren në konsideratë gjatë punës së ardhëshme analitike. Por nëse qoftë dhe një mostër e veçantë në laborator është në kundërshtim me këto limite, raporti do të përcaktohet duke përdorur 100 kokrrat e hequra mënjane.

2.TRAJTIMI I MOSTRAVE TË PRANUARA NË LABORATOR

Çdo mostër laboratorike grihet imët dhe përzihet tërësisht nëpërmjet një procesi të provuar për të arritur homogjenizim të plotë.

Në rastin kur zbatohet niveli maksimal tek lënda e thatë, përmbajtja e lëndës së thatë të produktit përcaktohet në një pjesë të mostrës së homogjenizuar duke përdorur një metodë që është vërtetuar se përcakton saktësisht përmbajtjen e lëndës së thatë.

3. Mostrat përsëritëse

Mostra përsëritëse përdoret kur ka mospajtim të operatorit të biznesit me të dhënat e analizës. Mostra përsëritëse merret nga mostra e përbërë e homogjenizuar.

4.METODA E ANALIZAVE TË PËRDORURA NGA LABORATORI DHE KËRKESAT E KONTROLLIT LABORATORIK

4.1. Përkufizime

Disa prej përcaktimeve të përdorura më shpesh që laboratorit do të zbatojë janë:

r - përsëritshmëria, vlera në të cilën diferenca absolute midis dy rezultateve të veçanta të testimit të marra në kushte të përsëritshmërisë, përkatësisht për të njëjtat mostra, operator, aparatura, laborator, dhe interval të shkurtër kohe, që supozohet se mashtrimi është brenda një probabiliteti të caktuar (zakonisht 95%) dhe kështu $r = 2.8 \times s_r$

s_r - devijimi standard, i llogaritur nga rezultatet e nxjera nën kushtet e përsëritshmërisë.

RSD_r - devijimi standard relativ i llogaritur nga rezultatet e nxjera në kushtet e përsëritshmërisë $[(s_r/x) \times 100]$.

R - riprodhueshmëria, vlera në të cilën diferenca absolute midis dy rezultateve të veçanta të testimit merret në kushte të riprodhueshmërisë, përkatësisht materiale të njëjta të marra nga operatorët në laboratorë të ndryshëm, duke përdorur metodën e testit të standardizuar që supozohet se mashtrimi është brenda një probabiliteti të caktuar (zakonisht 95%); $R = 2.8 \times S_R$

S_R - devijimi standard, i llogaritur nga rezultatet e nxjera në kushtet e riprodhueshmërisë.

RSD_R = devijimi standard relativ i llogaritur nga rezultatet e nxjera në kushtet e riprodhueshmërisë; $[(S_R/x) \times 100]$.

4.2. Kërkesat e përgjithshme

Metodat e analizave të përdorura për qëllime të kontrollit të ushqimeve duhet të pajtohen me dispozitat e pikave 1 dhe 2 të Shtojcës III të Urdherit Nr.382, dt. 31.07.2006, “Mbi organizimin e kontrolleve zyrtare, për zbatimin e rregullave për ushqimin e njerëzve, të kafshëve si dhe për shëndetin e mirëqënien e kafshëve”.

4.3. Kërkesat specifike

4.3.1. Kriteret e kryerjes

Kur nuk ka metoda specifike për përcaktimin e niveleve të mycotoxinave në produktet ushqimore, laboratorët mund të zgjedhin ndonjë metodë me kusht që metoda e zgjedhur të plotësojë kriteret e mëposhtme:

(a) Kriteret e performancës për aflatoxinat

Kriteret	Kufijt përqendrimit	Vlerat rekomanduara	Vlerat maksimale të lejuara
	Te gjithë	Te paperfillshme	-
Gjetjet-Aflatoxin M1	0,01-0,05 µg / kg	60-120%	
	> 0,05 µg / kg	70-110%	
Gjetjet Aflatoxinave B1, B2, G1, G2	<1,0 µg / kg	50-120%	
	10/01 µg / kg	70-110%	
	> 10 µg / kg	80-110%	
Saktësia RSD _R	Te gjithë	vlera I Ekuacionit Horëitz	2 x vleren e Ekuacionit Horëitz
Saktësia RSD _r mund të llogaritet si 0,66 herë e saktësisë RSD _R per përqëndrimin në fjaë			

Shënim:

- Vlerat të zbatohen për të dyja B1 dhe shumën e B1 + B2 + G1 + G2.
- Nëse shuma e aflatoxinave individuale B1 + B2 + G1 + G2 janë raportuar, atëherë reagimi për secilin sistem analitik duhet të jetë i njohur ose ekuivalent.

(b) kriteret e performancës për ochratoxin A

Niveli µg / kg	OchratoxinA		
	RSD _R %	RSD _r %	Gjetja %
<1	≤ 40	≤ 60	50-120
10-10	≤ 20	≤ 30	70-110

(c) kriteret e performancës për patulin

Niveli $\mu\text{g} / \text{kg}$	Patulin		
	RSD _R %	RSD _r %	Gjetja %
<20	≤ 30	≤ 40	50-120
20-50	≤ 20	≤ 30	70-105

(d) kriteret e performancës për deoxynivalenol

Niveli $\mu\text{g} / \text{kg}$	Deoxynivalenol		
	RSD _R %	RSD _r %	Gjetja %
> 100 \leq 500	≤ 20	≤ 40	60-110
>500	≤ 20	≤ 40	70-120

(e) kriteret e performancës për Zearalenone

Niveli $\mu\text{g} / \text{kg}$	Zearalenone		
	RSD _R %	RSD _r %	Gjetja %
≤ 50	≤ 40	≤ 50	60-120
>50	≤ 25	≤ 40	70-120

(f) kriteret e performancës për Fumonisin B1 dhe B2

Niveli $\mu\text{g} / \text{kg}$	Fumonisin B1 dhe B2		
	RSD _R %	RSD _r %	Gjetja %
≤ 500	≤ 30	≤ 60	60-120
>500	≤ 20	≤ 30	70-110

(g) kriteret e performancës për toksinat T-2 dhe HT-2

Niveli $\mu\text{g} / \text{kg}$	Toksinat T-2		
	RSD _R %	RSD _r %	Gjetja %
50-250	≤ 40	≤ 60	60-130
> 250	≤ 30	≤ 50	60-130

Niveli $\mu\text{g} / \text{kg}$	Toksinat HT-2		
	RSDR%	RSDr%	Gjetja %
100-200	≤ 40	≤ 60	60-130
> 200	≤ 30	≤ 50	60-130

(h) Shënime për kriteret e performancës për mycotoxinat

Kufijtë e zbulimit të metodave të përdorura, të pashpallura si vlera saktësie që jepen për përqëndrimet në fjalë.

Vlerat e saktësisë janë llogaritur nga ekuacioni Horwitz, dmth:

$$\text{RSD}_R = 2^{(1-0,5\log C)}$$

RSD_R- është devijimi standard relativ, i llogaritur prej rezultateve të marra në kushtet e riprodhueshmërisë $[(S_{R\sqrt{X}}) \times 100]$

- C është raporti i përqëndrimit (dmth 1 = 100g/100g, 0001 = 1 000 mg / kg)

Ky është një ekuacion saktësie i gjetur si i pavarur nga analizimi dhe matrica por varet vetëm nga përqëndrimi për shumicën e metodave rutinë të analizave.

4.3.2. 'Përshtatshmëri-për-qëllim' përafrimi

Në rastet kur ka një numër të kufizuar metodash të analizave plotësisht të vërtetuara, duhet të përdoret një 'përshtatshmëri-për-qëllim' përafrimi, për përcaktimin e një parametri të vetëm, një funksioni përshtatshmërie, që vlerëson pranueshmërinë e metodave të analizave të përdorura. Një funksion përshtatshmërie është një funksion pasigurie që specifikon nivelet maksimale të pasigurisë që njihet si përshtatje për qëllimin.

Dhënia e një numri të kufizuar metodash të analizave plotësisht të vërtetuara sipas një eksperimenti bashkëpunimi, veçanërisht për përcaktimin e toksinave T-2 dhe HT-2, për afrimin e funksionit të pasigurisë, specifikimit të pasigurisë maksimale të pranueshme, mundet gjithashtu të vlerësojë përshtatshmërinë e metodës së analizës të përdorur në laborator ('përshtatshmëri-për-qëllim'). Laboratori duhet të përdorë një metodë që paraqet rezultatet brenda pasigurisë maksimale standarte. Pasiguria maksimale standarte llogaritet duke përdorur formulën e mëposhtme:

$$U_f = \sqrt{(\text{LOD}/2)^2 + (a \times C)^2}$$

ku:

U_f- është pasiguria maksimale standarde ($\mu\text{g} / \text{kg}$)

LOD- është kufiri i zbulimit të metodës ($\mu\text{g} / \text{kg}$)

α -është një konstante, faktor numerik që do të përdoret në varësi të vlerës së C. Vlerat e përdorura paraqiten në tabelën e mëposhtme.

C është përqëndrimi në fjalë ($\mu\text{g} / \text{kg}$)

Nëse metoda analitike jep rezultate me matje të pasigurta më pak se pasiguria maksimale standarte, metoda do të konsiderohet njëlloj e përshtatshme me një që plotëson kriterin e dhënë në pikën 4.1.1.

Tabelë

Vlerat numerike të përdorura si të përhershme në formulën e paraqitur në këtë pikë, në varësi të përqëndrimit.

C ($\mu\text{g} / \text{kg}$)	α
≤ 50	0.2
51-500	0.18
501-1000	0.15
1001-10000	0.12
>10000	0.1

4.4. Llogaritja e pasigurisë së matjeve, kryerja e llogaritjeve dhe raportimi i rezultateve

Rezultati analitik duhet të raportohet korrekt ose jokorrektja të përpunohet. Mënyra e raportimit dhe niveli i përpunimit duhen raportuar. Rezultati analitik i korigjuar nga përpunimi do të përdoret për kontrollin e pajtueshmërisë.

Rezultati analitik të raportohet si $x \pm U$ ku x -është rezultati analitik dhe U shpreh pasigurinë e matjeve

U shpreh pasigurinë matëse të zgjeruar, duke përdorur një faktor sigurie 2 e cila jep një nivel besimi përafërsisht 95%.

Rregullat interpretuese të tanishme të rezultatit analitik për shkak të pranimit ose refuzimit të lotit zbatohen për rezultatin analitik të përdorur në mostrën e marrë për kontroll zyrtar.

4.5. Standardet cilësore laboratorike

Laboratori duhet të pajtohet me dispozitat e Nenit 12 të Urdhërit Nr.382, dt. 31.07.2006, “Mbi organizimin e kontrolleve zyrtare, për zbatimin e rregullave për ushqimin e njerëzve, të kafshëve si dhe për shëndetin e mirëqënien e kafshëve”.

